

WILLIAM SHAKESPIRE

BIBLIOTEKA

847-1

5432



WILLIAM SHAKESPEARE

1564-1616

Poete



820-1

841
3432

WILIAM SHEKSPIR

Sonete

sonete

Shqipëroi

Vedat Kokona



TOENA, 1995

Korrektor: **Fatmir Mema**
Grafika: **Blerina Bala**



Drejtor botues: **Fatmir Toçi**

© Shtëpia Botuese **TOENA**
Rr. "Muhamet Gjollësia"
Kutia Postare nr. 1420
TIRANE



WILLIAM SHAKESPEARE
1564-1616





I


From fairest creatures we desire increase,
That thereby beaut's rose might never die,
But as the riper should by time decease,
His tender heir might bear his memory:
But thou, contracted to thine own bright eyes,
Feed'st thy light's flame with self-substantial fuel,
Making a famine where abundance lies,
Thyself thy foe, to thy sweetself too cruel.
Thou that art now the world's fresh ornament
And only herald to the gaudy spring,
Within thine own bud buriest thy content
And, tender churl, makest waste in niggarding.
Pity the world, or else this glutton be,
To eat the world's due, by the grave and thee.





I

Nga çdo krijesë e bukur duam shtesë
 Që trëndafil'i bukuris' mos fishket;
 Por, kur të piqet, gjë prej saj mos mbesë,
 Burbuqja në kujtim të përtërihet.
 Por ti, i kredhur n'ata sy plot dritë,
 Me frymën tënde flakën e mban gjallë;
 Shkakton uri ku derdhen mirësitë,
 Armik i vetes përse bëhesh vallë?
 Tani stoli që je i rruzullimit,
 Kasnec pa shok pranvere të shkëlqyer,
 Në gonxhen tënde ti varros gëzimin,
 Në varfëri thesar' ke për ta kthyer.
 Botën mëshiro, mbaje kët thesar
 Dhe bukurin' mos e mbulo në varr.





II

When forty winters shall besiege thy brow,
And dig deep trenches in thy beauty's field,
Thy youth's proud livery, so gazed on now,
Will be a tatter'd weed, of small worth held;
Then being ask'd where all thy beauty lies,
Where all the treasures of thy lusty days,
To say, within thine own deep sunken eyes,
Were an all-eating shame and thriftless praise.
How much more praise deserv'd thy beauty's use,
If thou couldst answer -"This fair child of mine
Shall sum my count, and make my old excuse,"
Proving his beauty by succession thine!
This were to be new-made when thou art old,
And see thy blood warm when thou feel'st it cold.



II

Kur dyzet dimra ballin të ta thajnë
 Dhe të ta fishkin gjithë bukurinë,
 Kur zhele do të bjerë nga çdo anë
 Ky petk që sot ty ta solis rininë,
 Kur të të pyesin: "Vallë ku ka ikur
 Ai thesar i shtrenjtë i bukurisë?"
 Të thuash: "Ja këtu në sytë e fikur",
 Do t'ish një turp i madh i kotësisë.
 Po sa do mburreshe atë ditë sikur
 T'u thoshe: "Ja, ky djalë ç'ma ndriti pleqerinë!
 Ky bir ka trashëguar atë nur
 Që m'iku për ngaherë me rininë!"
 Dhe kur n'acar të pleqeris' të ngrish,
 Gjakun të nxeht' në dej do ndiesh sërish.





VII

Ino, in the orient when the gracious light
Lifts up his burning head, each under eye
Doth homage to his new-appearing sight,
Serving with looks his sacred majesty;
And having climb'd the steep-up heavenly hill,
Resembling strong youth in his middle age,
Yet mortal looks adore his beauty still,
Attending on his golden pilgrimage;
But when from highmost pitch, with weary car
Like feeble age, he reeleth from the day,
The eyes, 'fore duteous, now converted are
From his low tract, and look another way:
So thou, thyself out-going in thy noon,
Unlook'd on diest, unless thou get a son.






VII

Shiko, nga lindja sa ka nisur dielli
 Kokën e zjarrt' ta ngrejë plot shkëlqim;
 Sytë nga toka drejtohen nga qielli
 Dh'e përshtëndesin plot me adhurim.
 Pastaj si ngjitet deri lart në kulm,
 Në breshërinë e dritës tij të zjarrtë,
 Sytë që poshtë e shohin prap' me ngulm
 Duke e ndjekur në shtegtim'n e artë.
 Por kur nga kulmi i lodhur nis të zbresë
 Edhe të marrë udh'n e perëndimit,
 Syt' plot respekt që e shihnin kët' shkëlqesë
 Tani këmbejnë shtegun e drejtimit.

Ashtu dhe ti do mbeç i shkret' pa fjalë
 Sa je i ri nga pas mos lënç një djalë.





IX

It is for fear to wet a widow's eye
That thou consumest thyself in single life?
Ah! if thou issueless shalt hap to die,
The world will wail thee, like a makeless wife;
The world will be thy widow, and still weep
That thou no form of thee hast left behind,
When every private widow well may keep
By children's eyes her husband's shape in mind.
Look, what an unthrift in the world doth spend
Shifts but his place, for still the world enjoys it;
But beauty's waste hath in the world an end,
And kept unused, the user so destroys it.
No love toward others in that bosom sits
That on himself such murderous shame commits.





IX

Ke frikë se vejushen mos lësh vetëm
 Mbytur në lot që rri i pamartuar?
 Pa djal' kështu sikur ta lësh ti jetën
 Me kuje bota ka për të vajtuar.
 Vejusha jote bota do të jetë,
 Në lot do shkrij' pa djalë ti në shkofsh;
 Kur çdo vejushe para saj do ketë
 Në sytë e djalit ninzën e të shoqt.
 Ajo, që shkapërdari prish pa u menduar,
 S'humbet, se shkon diku dhe prapë vlen;
 Por bukuria, si të ket' kaluar,
 Si dhe rinia ikën dhe më s'vjen.
 Te ty ndaj tjerve s'paska dashuri
 Qëkur ndaj vetes kaq mizor je ti.





XVII

Who will believe my verse in time to come,
If it were fill'd with your most high deserts?
Though yet, Heaven knows, it is but as a tomb
Which hides your life, and shows not half your parts.
If I could write the beauty of your eyes,
And in fresh numbers number all your graces,
The age to come would say 'This poet lies;
Such heavenly touches ne'er touch'd earthly
faces.

So should my papers, yellow'd with their age,
Be scorn'd, like old men of less truth than tongue;
And your true rights be term'd a poet's rage,
And stretched metre of an antique song:
But were some child of yours alive that time,
You should live twice,- in it, and in my rhyme.





XVII

Kush i beson në t'arthmen vargut tim
 Edhe sikur të ndrijë nga hiri yt?
 Si i një varri ai është shëmbëllim
 Që jetën tënde në terrinë e mbyt.
 Në varg të ri të shkrija bukurinë
 E syvet tu dhe gjithë nurin tënd,
 "Gënjen" do thoshin brezat që do vinë,
 E tillë bukuri s'lind në asnjë vend!"
 Edhe ky varg nga koha ashtu i zverdhur
 Dhe i përbuzur do të flaket tej,
 Si llotitje e një plaku të rrjedhur,
 O marrëzi poeti teveqel.
 Por djal' në lënç pas teje trashëgim,
 Te ai do rrosh si dhe te vargu im.





XXIII

As an unperfect actor on the stage,
Who with his fear is put besides his part,
Or some fierce thing replete with too much rage,
Whose strength's abundance weakens his own heart
So I, for fear of trust, forget to say
The perfect ceremony of love's rite,
And in mine own love's strength seem to decay,
O'ercharged with burden of mine own love's might.
O let my books be then the eloquence
And dumb presagers of my speaking breast;
Who plead for love, and look for recompense,
More than that tongue that more hath more express'd
O learn to read what silent love hath writ:
To hear with eyes belongs to love's fine wit.





XXIII

Si një aktor i dobët që në skenë
 Nga frika rolin fare e harron,
 Apo si ai nga pezmi që zë zien
 Sa valë e forcës zemrën ia ligsh-ton,
 Ashtu dhe un' nga frika s'di t'i them
 Fjalët që i kanë hije dashurisë
 Që më ka shëmbur edhe bërë ujëm,
 Nën' zgjedh'n e saj keq fort më ka molisë.
 Librat e mi ti lëri, pra, të jenë
 Kasnecë të nemitur të këtij gjiri;
 Shpërblim e dashuri te ty kërkojn' të gjejnë
 Më shumë se gjuha që u shpreh më së miri.
 Fjalët e dashurisë së heshtur i lexo,
 Dëgjo me sy, siç bën ai që do.





XXVII

Wearied with toil, I haste me to my bed,
The dear repose for limbs with travel tired;
But then begins a journey in my head,
To work my mind, when body's work expir'd:
For then my thoughts (from far where I abide)
Intend a zealous pilgrimage to thee,
And keep my drooping eyelids open wide,
Looking on darkness which the blind do see:
Save that my soul's imaginary sight
Presents thy shadow to my sightless view,
Which, like a jewel hung in ghastly night,
Makes black night beauteous and her old face new.
Lo, thus, by day my limbs, by night my mind
For thee and for myself no quiet find.





XXVII

Lodhur nga puna bie për të fjetur
 Trupin ta çlodh nga udhëtimi i gjatë;
 Kur trupi çlodhjen më në fund ka gjetur,
 Mendja shtegtimin e nis nëpër natë.
 Aher' mendimet, porsì haxhilerë,
 Marrin një udhë e shkojnë drejt tek ti;
 Qepallat e rënduar s'mbyllen asnjëherë,
 Terrin shikojnë që e sheh i verbëti.
 Edhe aher' me sytë e mi të vdjerrë
 Me shpirtin tim un' hijen ta sodis,
 Që varur si stoli në natën sterrë,
 Të zezën natë e ndrit dhe e stolis.
 Pra, ditën trupi, natën truri im,
 Për ty dhe veten time s'gjejnë pushim.






XXVIII

How can I then return in happy plight,
That am debarr'd the benefit of rest?
When day's oppression is not eas'd by night,
But day by night, and night by day oppress'd?
And each, though enemies to either's reign,
Do in consent shake hands to torture me;
The one by toil, the other to complain
How far I toil, still farther off from thee.
I tell the day, to please him, thou art bright,
And dost him grace when clouds do blot the heaven;
So flatter I the swart-complexion'd night;
When sparkling stars twire not, thou gild'st the even.
But day doth daily draw my sorrows longer,
And night doth nightly make grief's strength seem
stronger.





XXVIII

Si të më qeshë buza pa më thua
 Kur shpirti im një çast nuk gjen pushim,
 Kur ditë e natë e natë e ditë unë vuaj,
 Për ankth' e ditës nata s'gjen shërim?
 Kur ditën nata e kjo ditën lufton,
 Bashkohen kundër meje e më sflisin:
 Dita me punë e nata rri vajton
 Sepse larg teje orët më mërzhisin.
 Ditës i them , ta marr pak me të mirë,
 Se ti e ndrit me re kur qielli nxin;
 Natës së zezë i them: "S'ka errësirë
 Kur ti, si yll, kur yjet s'ndrijnë, shëndrin."
 Çdo ditë më shumë venitem prej lëngatës,
 Çdo natë më i zi më duket terri i natës.





XXIX


When in disgrace with fortune and men's eyes,
I all alone bewep my outcast state,
And trouble deaf Heaven with my bootless cries,
And look upon myself, and curse my fate,
Wishing me like to one more rich in hope,
Featur'd like him, like him with friends posses'd,
Desiring this man's art, and that man's scope,
With what I most enjoy contented least;
Yet in these thoughts myself almost despising,
Haply I think on thee, and then my state
(Like to the lark at break of days arising
From sullen earth) sings hymns at heaven's gate;
For thy sweet love remember'd such wealth brings,
That then I scorn to change my state with kings.





XXIX

Kur shpirt helmuar strukem në vetmi
 Mjerimin tim kur qaj plot pikëllim,
 Qiellin trazoj me klithma pa dobi
 Dhe rri mallkoj ahere fatin tim;
 Një tjetër fat lakmoj un' më të mirë,
 T'akcilit hijeshinë ta kisha unë,
 Miqt e një tjetri, artin e vështirë,
 Atë që e kam më pak dhe e dua shumë.
 Edhe kështu, kur veten e urrej
 Për fat të sjell ndër mend dhe shpirti im
 (Si lauresha që ngjitet lart në qiej
 Nga toka e zyrtë) këndon plot ngazëllim:
 Se dashurinë e ëmbël tënde kur kujtoj
 As mbret të jem aherë nuk lakmoj.





XXX

When to the sessions of sweet silent thought
I summon up remembrance of things past,
I sigh the lack of many a thing I sought,
And with old woes new wail my dear time's waste:
Than can I drown an eye, unused to flow,
For precious friends hid in death's dateless night,
And weep afresh love's long since cancell'd woe,
And moan the expense of many a vanish'd sight;
Than can I grieve at grievances foregone,
And heavily from woe to woe tell o'er
The sad account of fore-bemoaned moan,
Which I new pay as if not paid before.
But if the while I think on thee, dear friend,
All losses are restor'd and sorrows end.





XXX

Kur sjell ndër mend kujtimin e nemitur
 Të zërave që humbën në greminë,
 Rri psherëtij p'r ata që janë venitur,
 Vajtoj me mall për ditët që më s'vinë.
 Dhe sytë e mi që nuk ishin mësuar
 Të derdhnin lot, ia shkrepin fort të qarit;
 Vajtoj për dashuritë e paharruar,
 Për shokët që në gjum' kan' rën' të varrit.
 Brengosem prap për brengat që më ranë,
 Çdo humbje prap më sjell një hidhërim;
 Vajtoj sërish ata që më nuk janë,
 Sikur nuk i kam qarë me lotin tim.
 Por ty kur të kujtoj çdo breng e mund,
 Harroj çdo humbje e çdo zymnim merr fund.





XXXI


Thy bosom is endeared with all hearts,
Which I by lacking have supposed dead;
And there reigns love, and all love's loving parts,
And all those friends which I thought buried.
How many a holy and obsequious tear
Hath dear religious love stol'n from mine eye,
As interest of the dead, which now appear
But things removed that hidden in thee lie!
Thou art the grave where buried love doth live,
Hung with the trophies of my lovers gone,
Who all their parts of me to thee did give;
That due of many now is thine alone;
Their images I loved I view in thee,
And thou, all they, hast all the all of me.





XXXI

Në gjirin tënd gjithë zemrat kanë selinë
 Të cilat kallur thosha janë në dhe;
 Të dashurve të zhdukur bukurinë
 Të pavenitur ruajtur e ke.
 Sa herë për të vdekurit kam qarë
 Nga dashuria e shenjtë i ngashëryer;
 Me lot kujtimin dendur ua kam larë,
 Por ti të gjithë ata i ke rrëmbyer.
 Ti varri je ku rron dashni e vdekur
 Me trofetë e të dashurve stolisur;
 Në veten tënde se ç'm'i paske tretur
 Ti copat e kësaj zemre të sflitur.
 Fytyrat më të dashura i gjej tek ti,
 I yti (i gjithë atyre) jam tani.





XXXIII

Full many a glorious morning have I seen
Flatter the mountain-tops with sovereign eye,
Kissing with golden face the meadows green,
Gilding pale streams with heavenly alchymy;
Anon permit the basest clouds to ride
With ugly rack on his celestial face,
And from the forlorn world his visage hide,
Stealing unseen to west with this disgrace;
Even so my sun one early morn did shine
With all triumphant splendour on my brow;
But, out, alack! he was but one hour mine,
The region cloud hath masked him from me now.
Yet him for this my love no whit disdaineth;
Suns of the world may stain, when heaven's sun
staineth.





XXXIII

Sa herë e kam shijuar bukurinë
 E nadjes dielli majat kur ndriçon;
 Kur shtrin fytyr'n e artë në lëndinë
 Dhe ujërat e zbeta i praron.
 Papritmas i lejon të mblidhen retë
 Fytyrën qiellore t'ia mbulojnë vështtrimit;
 Pa diell bota duket krejt e shkretë
 Kur tinës ai shket drejt perëndimit.
 Ashtu dhe dielli im më ndriti ndaj të gdhirë
 Dhe më verboi me rrezet plot shkëlqim;
 Ndriti një orë dhe, në errësirë,
 Më la tani, se retë u mblodhën plim.
 Kur dielli i qiellit fshihet prapa reve,
 Si mos na fshihet dielli i tokës neve?





XLIII

When most I wink, then do mine eyes best see,
For all the day they view things unrespected;
But when I sleep, in dreams they look on thee,
And, darkly bright, are bright in dark directed.
Then thou, whose shadow shadows doth make bright,
How would thy shadow's form form happy show
To the clear day with thy much clearer light,
When to unseeing eyes thy shade shines so!
How would, I say, mine eyes be blessed made
By looking on thee in the living day,
When in dead of night thy fair imperfect shade
Through heavy sleep on sightless eyes doth stay!
All days are nights to see, till I see thee,
And nights, bright days when dreams do show thee
me.





XLIII

Më mirë shoh kur natën sytë i mbyll;
 Se ditën s' shoh gjë tjetër veç përçmim;
 Në ëndërr më fanitesh si një yll
 Dhe të sodis në terrin plot shkëlqim.
 Ti, që me hijen tënde hijet i fekstin,
 Si do të dukej hija jote, thuaj,
 Ditën kur dielli shkrep e vetëtin,
 Kur hija jote verbon sytë e shuar?
 Me ç'drit' do t'i bekoje sytë e mi
 Kur të të shihnin në dritën e ditës,
 Kur hija jote në terr si stoli
 Më ndrin në gjumë si ylli llamburitës?
 Dita për mua, kur s'të shoh, s'ka dritë;
 Të shoh në ëndërr - nata bëhet ditë.





XLVI

Mine eye and heart are at a mortal war,
How to divide the conquest of thy sight;
Mine eye my heart thy picture's sight would bar,
My heart mine eye the freedom of that right.
My heart doth plead that thou in him dost lie,
A closed never pierced with cristal eyes,
But the defendant doth that plea deny,
And says in him thy fair appearance lies.
To 'cide this title is impannelled
A quest of thoughts, all tenants to the heart;
And by their verdict is determined
The clear eye's moiety and the dear heart's part:
As thus; mine eye's due is thine outward part,
And my heart's right thine inward love of heart.





XLVI

Sytë e mi dhe zemra janë në luftë të rreptë:
 Se kush do ta fitojë nurin tënd të rrallë;
 Sytë ia mohojnë zemrës këtë të drejtë,
 As zemra syve këtë thesar s'ua fal.
 Zemra kërkon të të ketë në gjë,
 (Kthinë ku s'depërtojnë sytë e kulluar),
 Por sytë nuk pranojnë kurrsesi
 Që t'u shpëtojë ky thesar i çmuar.
 Në një kuvend ahëre na u mblodhën
 Mendimet këtë punë për ta shoshitur;
 Se ç'do t'u jepej palëve vendosën,
 Syve të kulluar dhe zemrës së zhuritur:
 Syve t'u falnin gjithë bukurinë,
 Zemrës të zemrës sate dashurinë.





LXIII


Against my love shall be, as I am now,
With Time's injurious hand crush'd and o'erworn;
When hours have drain'd his blood and fill'd his
brow
With lines and wrinkles; when his youthful morn
Hath travell'd on to age's steepy night,
And all those beauties, whereof now he's king,
Are vanishing or vanish'd out of sight,
Stealing away the treasure of his spring ;
For such a time do I now fortify
Against confounding age's cruel knife,
That he shall never cut from memory
My sweet love's beauty, though my lover's life;
His beauty shall in these black lines be seen,
And they shall live, and he in them, still green.





LXIII

Kur Koha e nëmur do të bëjë kërدينë,
 Si mua ta dërrmojë thesarin tim,
 Acari i saj kur gjakun do t'ia ngrijë
 Dhe rrudhat në shëmtim t'ia kthejnë bukurinë;
 Mëngjesi i tij i bukur kur të thyhet
 Dhe n'errësirë të natës të mbarojë,
 Dhe gjithë kjo bukuri atje të zhytet
 Dhe pranverën në dimër t'ia ndryshojë;
 Për atë koh' e mpreh un këtë thikë:
 Ajo vërtet do t'ia rrëmbejë rininë
 Dhe jetën, por aspak un nuk kam frikë
 Që kujtimin t'ia fshijë bukurinë:
 Se nuri i tij, në këtë varg të zi,
 I gjallë do të mbetet si ai!





LXIV

When I have seen by Time's fell hand defaced
The rich-proud cost of outworn buried age;
When sometimes lofty towers I see down-razed,
And brass eternal slave to mortal rage;
When I have seen the hungry ocean gain
Advantage on the kingdom of the shore,
And the firm soil win of the watery main,
Increasing store with loss, and loss with store;
When I have seen such interchange of state,
Or state itself confounded to decay;
Ruin hath taught me thus to ruminare,
That Time will come and take my love away.
 This thought is as a death, which cannot choose
 But weep to have that which it fears to lose.





LXIV

Kur shoh se dora e Kohës kaq mizore
 Të shekujve që shkuan prishi bukurinë,
 Kur shoh përtokë kulla madhështore
 Dhe bronzin e përjetshëm vdekja si e grin;
 Kur shoh si turret vala në oqean
 Dhe mbretërisë së zallit tokat ia rrëmben,
 Pastaj dhe toka ujërat si i përllan,
 Të dy fitimi humbjen si shpërblen;
 Kur shoh se si ndërron çdo gjë në botë,
 Ku prishja veç sundon mbi gjithë stolitë,
 Me hidhërim rri e mendoj ndër lotë
 Se Koha nurin tënd do ma rrëmbejë një ditë.
 Ja, ky mendim si vdekje është për mua,
 Dhe qaj se mos humbas atë që dua.





LXV

Since brass, nor stone, nor earth, nor boundless sea,
But sad mortality o'ersways their power,
How with this rage shall beauty hold a plea
Whose action is no stronger than a flower?
O, how shall summer's honey breath hold out
Against the wreckful siege of battering days,
When rocks impregnable are not so stout,
Nor gates of steel so strong, but Time decays?
O fearful meditation! where, alack!
Shall Time's best jewel from Time's chest lie hid?
Or what strong hand can hold his swift foot back?
Or who his spoil of beauty can forbid?
O none, unless this miracle have might,
That in black ink my love may still shine bright.





LXV

Kur bronzi, guri, toka, deti pa kufi
 Vdekjen s'e mposhtin dot kur u vërsulet,
 Ç'të thotë bukuria në këtë stuhi
 Ajo që është e brishtë porsì lulet?
 Si t'i qëndrojë frymamjaltë e majit
 Rrethimit rrënimtar të ditëve në sulm,
 Kur shkrepat e thepìsur lart në zgrip të malit
 Dhe dyert prej çeliku Koha i humb?
 Mendim i lemerishëm! Po ku, vallë,
 Të Kohës do të ruajmë stolinë?
 Kush vallë at' çap'n e saj të shpejtë do ndalë,
 Kush s'do ta lër të fishket bukurinë?
 Askush, veçse në ngjaftë kjo mrekulli,
 Që në mellan'e zi të ndrìsh përjetë ti.





LXVI

Tir'd with all these for restful death I cry,
As, to behold desert a beggar born,
And needy nothing trimm'd in jollity,
And purest faith unhappily forsworn,
And gilded honour shamefully misplaced,
And maiden virtue rudely strumpeted,
And right perfection wrongfully disgraced,
And strength by limping sway disabled,
And art made tongue-tied by authority,
And folly, doctor-like, controlling skill,
And simple truth miscall'd simplicity,
And captive good attending captain ill;
Tired with all these, from these would I be gone,
Save that, to die, I leave my love alone.





LXVI

I lodhur nga të gjitha vdekjen e thërras,-
 Kur shoh meritën mbetur si jetim,
 Dhe varfanjakun veshur gjithë gaz,
 Dhe besimin e shkelur me përçmim,
 Dhe nderin lemerisht të poshtëruar,
 Dhe pastërtinë e vashës të përlyer,
 Dhe forcën nga i çali të munduar,
 Dhe artin nga pushteti gojëmbërthyer,
 Dhe mjeshtërinë shum' keq të telendisur,
 Dhe marrëzinë t'i prijë zotësisë,
 Dhe të vërtetën ta quajnë të stisur,
 Dhe ndjenjat t'i shërbejnë ligësisë,
 I lodhur nga këto, jetës i jepja fund,
 Por vetëm të të lë pas meje s'mund.





LXXI


No longer mourn for me when I am dead
Than you shall hear the surly sullen bell
Give warning to the world that I am fled
From this vile world, with vilest worms to dwell;
Nay, if you read this line, remember not
The hand that writ it; for I love you so,
That I in your sweet thoughts would be forgot,
If thinking on me then should make you woe.
O, if, I say, you look upon this verse
When I perhaps compounded am with clay,
Do not so much as my poor name rehearse;
But let your love even with my life decay;
Lest the wise world should look into your moan,
And mock you with me after I am gone.





LXXI

Mbaj zi për mua ditën që të vdes
 Sa të kumbojë kambana plot vajtim
 Me lajmin nga kjo botë e ndyrë unë zbres
 Ndër krimbat më të ndyrë të gjej pushim.
 Në m'i këndofsh kta vargje as ndër mend
 Mos sill atë që i shkroi; aq fort të dua,
 Sa s'dua ta lëndoj mendimin tënd
 Me hidhërim në më kujtosh ti mua.
 Në m'i këndofsh, them, vargjet që po shkruaj,
 Mbuluar varrin kur ta kem me bar,
 As emrin tim njeriu mos ia thuaj,
 Ti mbylle dashurinë me trupin tim në varr.
 Se s'dua jo, që bota të na tallë;
 Të ngrysur, kur të vdes, t'ta shohë ballë.





LXXVIII

So oft have I invoked thee for my Muze
And found such fair assistance in my verse
As every alien pen hath got my use,
And under thee their poesy disperse.
Thine eyes, that taught the dumb on high to sing
And heavy ignorance aloft to fly,
Have added feathers to the learned's wing,
And given grace a double majesty.
Yet be most proud of that which I compile,
Whose influence is thine, and born of thee:
In others' works thou dost but mend the style,
And arts with thy sweet graces graced be;
But thou art all my art, and dost advance
As high as learning my rude ignorance.





LXXVIII

Aq shpesh ke qenë për mua Muza ime
 Dhe vargun tim aq bukur ke qëndisur,
 Sa gjithë poetët ndoqën udhën time
 Dhe poezinë me ty e kanë stolisur.
 Memecin sytë e tu e bënë të këndoje,
 Paditurinë të ngrihet fluturim,
 Dhe krahut të mësuar pendë t'i shtojë,
 Dhe bukurisë t'i shtojë bukurinë.
 Krenar ji ti të gjitha për çka shkruaj,
 Se vargu im tek ty gjen frymëzim;
 Tek ty stolinë e gjen vargu i huaj,
 Por jetën ti ia fale vargut tim.
 Gjithë arti im je ti; lart e më lart
 Bonjakun vargun tim e ngre në art.





LXXXI

Or I shall live your epitaph to make,
Or you survive when I in earth am rotten;
From hence your memory death cannot take,
Although in me each part will be forgotten.
Your name from hence immortal life shall have,
Though I, once gone, to all the world must die;
The earth can yield me but a common grave,
When you entomb'd in men's eyes shall lie.
Your monument shall be my gentle verse,
Which eyes not yet created shall o'er-read;
And tongues to be, your being shall rehearse,
When all the breathers of this world are dead;
You still shall live (such virtue hath my pen)
Where breath most breathes, - even in the mouths of
men.





LXXXI

Nga ne të dy vallë kush do vdesë i pari
 Unë apo ti, s'e di; por një gjë di:
 Kujtimin tënd ty nuk ta mbulon varri
 I kalbur kur të jem në dhenë e zi.
 I paharruar emri yt do mbetet
 Kur unë nga kjo botë të jem fshirë;
 Një varr e aq nga toka do më ngelet
 Kur ti në varr do rrosh i përtërirë.
 Një monument për ty kto vargje po ndërtojnë
 Që sytë e pakrijuar një ditë do këndojnë;
 Dhe gjuhët që do vinë për ty do ligjërojnë
 Të vdekur kur të jenë ata që sot jetojnë.
 Ti vdekje s'ke: i tillë është art im
 Që në frymën e njerzve çdo çast të përtërin.





CVI

When in the chronicle of wasted time
I see descriptions of the fairest wights,
And beauty making beautiful old rhyme,
In praise of ladies dead and lovely knights,
Then, in the blazon of sweet beauty's best,
Of hand, of foot, of lip, of eye, of brow,
I see their antique pen would have express'd
Even such a beauty as you master now.
So all their praises are but prophecies
Of this our time, all you prefiguring;
And, for they look'd but with divining eyes,
They had not skill enough your worth to sing:
For we, which now behold these present days,
Have eyes to wonder, but lack tongues to praise.





CVI

Kur në kronikë të shekujve të shkuar
 Ndesh në përshkrime bukurish të vdjerrë,
 Vargje që bukuria ka kënduar
 Për zonjat dhe kalorësit e ndjerë;
 Si në pasqyrë kur shoh vetë bukurinë
 E dorës, këmbës, buzës, syrit tënd,
 Vallë si do ta thurte penda e lashtë lavdinë
 Tënde sikur të t' shihte përnjimend?
 Hiret e tua janë veç profeci
 E bukurisë që ata kanë ëndërruar;
 Me sy përfytyruan, s'mundën kurrsesi
 Në varg ta shtinin ty për të lavduar.
 Dhe ne që sot të shohim, të mahnitur,
 Lavdinë ta sodisim gjuhëlidhur.





CIX

O, never say that I was false of heart,
Though absence seem'd my flame to qualify!
As easy might I from myself depart,
As from my soul, which in thy breast doth lie:
That is my home of love; if I have rang'd,
Like him that travels, I return again;
Just to the time, not with the time exchang'd,
So that myself bring water for my stain.
Never believe, though in my nature reign'd
All frailties that besiege all kinds of blood,
That it could so preposterously be stain'd,
To leave for nothing all thy sum of good;
For nothing this wide universe I call,
Save thou, my rose; in it thou art my all.





CIX -

Jo, kurrë mos më quaj të pabesë:
 Larg teje zjarri im vlon përsëri;
 Si mund larg teje të isha në mungesë
 Kur shpirtin tim ti vetë e ke në gji?
 Atje strehohet zemra gjatë stuhisë;
 Në paça bredhur si shtegtar, sërish
 Ja ku po vij , besnik i dashurisë,
 Dhe të sjell ujë që njollën të ma fshish.
 Të meta kam vërtet, por asnjëherë
 Ato s'do të përlyejnë këtë gjak
 Sa unë të çmendem për diçka pa vlerë
 Të jap thesarin që kam shtënë në lak.
 Shkreti për mua është ky rruzullim
 Pa ty, o i bukuri trendafili im.





CXXVIII


How oft, when thou, my music, music play'st,
Upon that blessed wood whose motion sounds
With thy sweet fingers, when thou gently sway'st
The wiry concord that mine ear confounds,
Do I envy those jacks, that nimble leap
To kiss the tender inward of thy hand,
Whilst my poor lips, which should that harvest reap,
At the wood's boldness by thee blushing stand!
To be so tickled, they would change their state
And situation with those dancing chips,
O'er whom thy fingers walk with gentle gait,
Making dead wood more bless'd than living lips.
 Since saucy jacks so happy are in this,
 Give them thy fingers, me thy lips to kiss.





CXXVIII

Sa herë që ti, o moj muzika ime,
 Luan muzikë dhe derdh melodi
 Kur preklat përkëdhelin gishtërinjtë
 Dhe telat tingëlljnë plot harmoni,
 Oh, sa zili i kam preklat e shpejta
 Që hidhen e t'i puthin ato duar,
 Kur pranë buzët e mia të shkreta
 Digjen si prush dhe rrinë turpëruar.
 Kur buzët shohin se si në tastierë
 Gishtat preklat çapkënë i gudulisin,
 Sa duan prekla të ishin menjëherë
 Që drunë e vdekur më mos ta zilisnin.
 Me kaq kur preklat u gëzokan, dua:
 Atyre faliu gishtat - buzët mua.





CXXX


My mistress' eyes are nothing like the sun;
Coral is far more red than her lips' red:
If snow be white, why then her breasts are dun;
If hairs be wires, black wires grow on her head.
I have seen roses damask'd red and white,
But no such roses see I in her cheeks;
And in some perfumes is there more delight
Than in the breath that from my mistress reeks.
I love to hear her speak, yet well I know
That music hath a far more pleasing sound:
I grant I never saw a goddess go,
My mistress, when she walks, treads on the ground:
And yet, by heaven, I think my love as rare
As any she belied with false compare.





CXXX

Si dielli s'janë sytë e mikes sime;
 M'i kuq korali është se buza e saj;
 E bardhë bora, e zeshkët ngjyra e gjinjve,
 Në kokë i derdhet e errëta floknajë.
 Trëndafila të kuq, të bardh' kam parë,
 Por faqeve të saj s'kam parë të tillë;
 M'i ëmbël shumë është kundërmim' i lules
 Se era e djersës që i lëshojnë gjinjtë.
 Shkrihem kur e dëgjoj, edhe pse melodi
 Më t'ëmbël ka muzika kur kumbon,
 Si ecën një hyjneshë unë s'di,
 Në tokë shkel mikja ime kur kalon.
 Po ja ku po bëj be për perëndi
 Si ajo nuk shohin më kta sytë e mi.





CXXXI


Thou art as tyrannous, so as thou art,
As those whose beauties proudly make them cruel;
For well thou know'st to my dear doting heart
Thou art the fairest and most precious jewel.
Yet, in good faith, some say that thee behold,
Thy face hath not the power to make love groan:
To say they err I dare not be so bold,
Although I swear it to myself alone.
And to be sure that is not false I swear,
A thousand groans, but thinking on thy face,
One on another's neck, do witness bear
Thy black is fairest in my judgement's place.
In nothing art thou black save in thy deeds,
And thence this slander, as I think, proceeds.






CXXXI

Mizore je si bukurit' krenare
 Që bukuria i lind plot mizori;
 Ti mirë e di se zemra e dehur fare
 Të mban si më të vyerën stoli.
 Se hiri yt, - të tjerët ç'kam dëgjuar,-
 Zemrën ta shkrij' në lot s'paska fuqi;
 Guxim nuk kam të them se kan' gabuar,
 Bëj be se kanë të drejtë dhe e di.
 Dhe përsëri bëj be plot me rënkime
 Se nuri yt i zi, ajo floknajë
 T' errët ashtu siç janë zemra ime
 Posi stoli të shtrenjta do t'i mbajë.
 E zezë nuk je ti, jo, nga fytyra,
 E zezë je nga gjith' këto mynxyra.





CXLI


In faith I do not love thee with mine eyes,
For they in thee a thousand errors note;
But 'tis my heart that loves what they despise,
Who in despite of view is pleased to dote.
Nor are my ears with thy tongue's tune delighted;
Nor tender feeling, to base touches prone,
Nor taste nor smell, desire to be invited
To any sensual feast with thee alone:
But my five wits, nor my five senses can
Dissuade one foolish heart from serving thee.
Who leaves unsway'd the likeness of a man,
Thy proud heart's slave and vassal wretch to be:
Only my plague thus far I count my gain,
That she that makes me sin, awards me pain.





CXLI

Të them të drejtën sytë e mi s'të duan:
 Ç'të meta ke ata fort mirë e dinë;
 Por zemra ime të metat e tua
 As që i sheh dhe të fal dashurinë.
 Të gjuhës sate as veshët ligjërimin
 S'ta duan, as të duarve përkëdhelitë,
 As pamjen, zërin, as dhe kundërmimin
 Që në gosti më ftojnë si çdo ditë.
 As pesë shqisat as dhe mendja e shkretë
 Ksaj zemre tarallake ç't'i bëjnë s'dinë;
 Më kot mundohen shërim për t'i gjetë,
 Që tej ta flakë që sot robërinë.
 Por prap në këtë breng' jam i gëzuar:
 O ti, mëkati im, ç'më ke dërrmuar!





CXLVII


My love is as a fever, longing still
For that which longer nurseth the disease;
Feeding on that which doth preserve the ill,
The uncertain sickly appetite to please.
My reason, the physician to my love,
Angry that his prescription are not kept,
Hath left me, and I desperate now approve,
Desire his death, which physic did except.
Past cure I am, now reason is past care,
And frantic- mad with evermore unrest;
My thoughts and my discourse as mad men's are,
At random from the truth vainly express'd;
For I have sworn thee fair, and thought thee bright,
Who art as black as hell, as dark as night.





CXLVII

Posi lëngatë është zjarri i dashurisë
 Që s'ngopet kurrë me helmin që e helmon;
 Për t'i pushuar dhembjet e urisë
 Me vrer ushqehet shpirti kur lëngon.
 Dhe mendja që mjekonte dashurinë,
 M'u zemërua, iku dhe më la;
 Në hall të madh më la mua të zinë,
 Se asnjëherë s'bëra si më tha.
 Tani sëmundja ime s'ka shërim;
 Kjo buzë e shkretë s'bëhet kurrë në gaz;
 Si i shkalluar s'gjej një çast pushim,
 Dhe s'di ç'mendoj, e s'di as vetë ç'flas.
 Të dija diell që dritë kudo shpërndan,
 Por qenke natë sterrë e ferr katran.





CXLVIII

Ome! What eyes hath love put in my head,
Which have no correspondence with true sight!
Or, if they have, where is my judgment fled,
That censures falsely what they see aright?
If that be fair whereon my false eyes dote,
What means the world to say it is not so?
If it be not, then love doth well denote
Love's eye is not so true as all men's: no,
How can it? O how can Love's eye be true,
That is so vex'd with watching and with tears?
No marvel then though I mistake my view;
The sun itself sees not till heaven clears.

O cunning Love! with tears thou keep'st me blind,
Lest eyes well-seeing thy foul faults should find.





CXLVIII

Ⓟ dashuri, çfarë sy më vure, moj, në ballë
 Që ky vështrimi im ngahera më gabon?
 Në mos po mendja ku ka fluturuar vallë
 Që ndryshe i sheh gjërat, ndryshe i gjykon?
 Në është hijeshi ajo që, i mahnitur,
 Rri e sodis, pse bota thonë se jam gabuar?
 Në s'është, dashuria mendjen ma ka ndritur
 Se syri i dashurisë është verbuar.
 Si të mos jetë i verbër syri i dashurisë
 Nga lotët i venitur në pagjumësi?
 Pra, kam pse të gabohe: gjatë stuhisë
 As dielli nuk sheh kur qielli është me shi.
 Të verbër, dashuri dinake, ti më mban,
 Të metat mos t't'i shohë syri im që qan.





P a s t h ë n i e

Këto pak sonete të Shekspirit ndofta nuk do t'i kisha përktyer kurrë sikur të mos m'i kish kërkuar rasti. Ishte viti 1940, kur merresha me studimin e anglishtes duke ndjekur mësimet e emisioneve të BBC-së që përsëriteshin disa herë në ditë. Mësimet fillestare të së hënës dhe së martës shkallëzoheshin në vështirësi gjatë javës derisa, të shtunën, ditën e fundit, recitoheshin me një mjeshtri të rrallë copa të zgjedhura proze dhe poezie të letërsisë angleze. Këto mësimet letërsie, ndonëse të vështira për njohuritë e mia të atëhershme në nivelin gjuhësor, i ndiqja me vëmendje dhe interesim të veçantë. Kështu u njoha, për herë të parë, me prozën e bukur të Spectator-it, të Addisonit, që më kumbonte në vesh si proza e Madame de Sévigné, apo e Volterit. Një ditë dëgjova diçka që më tronditi thellë. Mësuesi, që ishte, si duket, edhe aktor nga mënyra se si recitonte aq bukur vargjet me një zë të melodishëm që më preku që në tingujt e parë, tha se do të recitonte sonetin e 65 të Shekspirit dhe porositi të merrnim një penë dhe një copë letër për të



shkruar poezinë, të cilën, pasi ta lexonte në fillim me shpejtësinë e zakonshme, do ta thoshte përsëri, por këtë radhë, at dictation speed, në mënyrë që nxënësittë mund ta shkruanin. Ndoqa me kujdes këshillën e profesorit dhe e shkrova sonetin. Pastaj profesori e recitoi edhe një herë sonetin me ritmin e zakonshëm. Dëgjimi i tretë, që vinte pasi qenë shpjeguar fjalët e vështira të sonetit dhe kur teksti ishte bërë shumë më i kuptueshëm, pati një kumbim mahnitës për mua që isha tashmë i dehur që në të parin, si ai udhëtari që, i lodhur nga një udhë e gjatë, me sy të përgjumur, ndodhet papritmas para një pamjeje mbytur në dritë dhe bukuri: "Since brass, nor stone, nor earth, nor boundless sea ...". E mësova përmendësh sonetin brenda asaj gjysëm ore që kishte vazhduar mësimi dhe, një ditë, shumë vjet më vonë, në disa rrethana që nuk ishin aspak të volitshme për të përkëdhelur Muzën tek ëndërroja, siç më ndodh shpesh, më kumboi në vesh ky varg: "Kur bronzi, guri, toka, deti pa kufi...". Vargu i Shekspirit më kumboi në shqip vetvetiu me të njejtin ritëm dhe rimë të fjalës së fundit të vargut që tingëllonte me "i". Por vazhdimi nuk ishte aspak i lehtë. U desh të kalonin edhe disa vjet të tjerë kur, në vitin



1958, e botova në Revisën "Nëndori" bashkë me shtatë sonete të tjerë.

Një përputhje e habitshme rrethanash ndodhi shumë vjet më vonë në një qytet, - dhe ç'qytet! - kus'ma priste mendja kurrë që të shkoja gjatë gjysmë shekulli që ndenja si zog në kuvli. Më 1990 vajta në Londër, i ftuar nga kunati im. Aty njoha mikun anglez të kunatit, avokatin-noter David Keating, i cili na shtroi një darkë në një klub të Londrës. Në darkë ndodhej edhe një nëpunës i Ministrisë së Jashtme bashkë me zonjën. E shoqja e fliste frëngjishten rrjedhshëm, kurrse a jo. Pata fatin të jem ulur pranë tij, dhe u detyrova të flas gjithë kohën anglisht, gjë që s'e kam në thua. Bashkëfolësi, - në mos gabohem, - Mister Martin, meqë dinte që kisha përkthyer Koperfildin e Dikensit, disa komeditë Shekspiritsi dhe disa sonete, më tha: "Kur isha në kolezh, mbaj mend se profesori na komentoi një ditë sonetin: "Since brass, nor stone, nor earth, nor boundless sea". Unë e ndërpreva dhe vazhdova: "But sad mortality o' ersways their power..." Ai mbeti pa mend, më vështroi gjatë sikur s'u zinte besë veshëve dhe tha: "Unbelievable!" I thashë se nuk kishte asgjë të pabesueshme në këtë rast dhe se do të kisha qënë



me të vërtetë një fenomen sikur t'i dija përmendsh të gjithë sonetet e Shekspirit, por që, për fat të keq, dija vetëm këtë. Dhe i tregova se si e kisha mësuar këtë poezi pesëdhjet vjet të shkuara.. Si zbritëm nga zonat eterike në tokën e Anteut, i përpoqëm gotat me një cheers.

* * *

Ç'janë sonetet e Shekspirit dhe ç'është thënë për to?

Me sa duket, Shekspiri ka filluar të shkruajë sonete në fillim të viteve 1590. Në komedinë e hershme të tij "Mundimet e kota të dashurisë" dialogu, herë-herë, merr formën e sonetit. Sipas biografëve, Shekspiri atëhere shkante shpesh në pallatin e kontit Southempton, të cilit atëhere i kishte kushtuar dy poemat e tij "Venusi dhe Adonisi" dhe "Përdhunimi i Lukrecës". Në këtë pallat, zburuar me dyer të gdhendura plot ojme dhe me mure të veshura me qilimë të bukur dhe të stolisura me piktura të mjeshtërve italianë, luhej shpesh muzikë italiane dhe, ca më shpesh, këndoheshin edhe sonete. Më 1598, Meres, përmend



"sonetet e ëmbra të Shekspirit që ishin bërë të njohura në rrethin e miqve të tij. Në vitin 1599, botuesi, William Graggard, botoi dy sonete të Shekspirit dhe, më në fund, më 1609, të gjitha sonetet dolën në botim të veçantë.

Botuesi i këtij libërthi, Thomas Torp, në kushtimin e këtyre soneteve, i drejtohet një personi që shënohet me gërmat nistore "W.H" E ç'nuk është shkruar për të zbuluar personin që fshihej prapa këtyre dygërmave! Këto ua vishnin Henry Wriothesly-t kontit të Southamptonit dhe William Herbertit, kontit të Pembrokut. Jo vetëm, po edhe shumë të tjerëve, të njohur dhe të panjohur. Puna arriti deri aty sa, një shakaxhi, hodhi mendimin se këto gërma s'fshihnin asgjë më shumë se "William Himself", domethënë Shekspirin vetë! Domethënë autori ia kushtonte vetvetes këto sonete! Këtë "zbulim" e mbështeti shumë seriozisht Baristorffi, komentuesi gjerman i Shekspirit.

Nuk është nevoja të ndalemi në çështje që nuk ngrihen mbi fakte të provuara. Le të kalojmë më mirë në një temë tjetër, shumë më interesante, që dotë na shërbejë për ndriçimin e skutave të fshehta që ruajnë përbrenda këto sonete.



Sipas mendimit më të përhapur dhe më të shëndoshë, personat për të cilët bëhet fjalë në këto sonete janë tre: poeti, miku i tij dhe "zonja zeshkane". Sipas këtij arsyetimi, të nëntëdhjetenëntë sonetet e para i kushtohen mikut.

Duhet thënë se Shekspiri e vlerësonte shumë lart ndjenjën e miqësisë, të cilën e ka shfaqur në "Dyzotërinj nga Verona" në figurën e Valentinit, në "Hamletin", në figurën e Horacit. Sipas Shekspirit, miqësia provon të gjitha ndjenjat e njeriut: gëzimin që faltakimi me mikun, hidhërimin e ndarjes, brengën që shkakton xhelozia. Duhet vënë re gjithashtu se edhe gjuha e asaj kohe, që shprehte ndjenjat e thella të miqësisë, ishte po ajo që shprehte edhe ajo e dashurisë, gjuha e madrigaleve. Atyre të Rilindjes u këndonte zemra e ngazëlluar nga ndjenja të holla dashurie dhe fisnikërie.

Ç'i thotë mikut Shekspiri në sonetet e tij? Të heqë dorë nga vetmia, të martohet, të selitet, të trashëgohet, sepse hijeshia, që sot rrëngjen në fytyrën e tij, me kohë do të venitet dhe do të zhuket përngaherë, veç në mos lëntë një trashëgimtar që të ruajë, si pasqyrë e gjallë, bukurinë e tij të sotme. vetëm kështu kjo bukuri do t'i shpëtojë "thikës" së



Kohës. Poeti qahet për fatin e mikut, në të cilin dashuria për të është ngushëllimi i vetëm. Në sonetet 128, 141, 147, 148 na del në skenë një figurë e re: "zonja zeshkane", që fut grindjen midis poetit dhe mikut të vet. Poeti e do shumë zeshkanen por, megjithatë, e qorton për vuajtjet që i shkakton ajo atij dhe mikut.

Sonetet janë shumë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Sa më shumë që të hysh në brendinë e tyre, aq më thellë do të ndjesh të fshehtën që ruajnë përbrenda. Dhe do të bindesh se temat që trajtojnë ato janë shumë më të thella dhe se aty bëhet fjalë për më shumë se dy veta, sepse ato pasqyrojnë fakte të ndryshme që nuk na i jep neve biografia shumë pak e njohur e dramaturgut dhe e poetit të madh, ngaqë ato janë shkruar në kohëra dhe rrethana të ndryshme të jetës. Ku dihet, për shembull, se shumica e soneteve i janë kushtuar vetëm një miku? Përse të mos mendohet se shumica nga ato sonete i kushtohen një të dashure? Dhe këtu na del diçka enigmatike: dihet se në gjuhën angleze mbiemrat nuk kanë ndryshim gjinie në mashkullore dhe femërore, kështuqë, në shumicën e rasteve, fjalët e ëmbla të dashurisë nuk dihet se kujt i drejtohen, një të dashure apo një miku? Përpara kësaj enigme përkthyesi le të pyesë zemrën e vet dhe të diktojë fjalët që i thotë ajo. Duhet thënë se teoria që pohon se



shumica e soneteve të Shekspirit hymnizon mikun u hodh, për herë të parë, nga fundi i shekullit XVIII. Deri atëhere ishin të mendimit se në shumë sonetet e veta Shekspiri e kishte fjalën për të dashurën e vet.

Evërteta është se këto sonete u ngjizën me ndjenjat e poetit. Këtë e shohim dhe e ndjejmë fare mirë nga ato dridhje e ngashërime që na shkaktojnë fjalët dridhëse të poezisë. Të ishin ashtu siç thotë Fletsheri në parathënjën e ciklit të soneteve të veta se "për dashurinë mund të shkruash edhe pa qënë i dashuruar, ashtu siç mund të shkruash për bujqësinë edhe pa ngarë parmendën", mund të bësh fare mirë sonete të akullta siç ka bërë ai vetë. Pati edhe kritikë që nuk ishin poetë por zemërmyllur, që nuk endjënë drithërimin dhe afshin e tyre. Kishte edhe nga ata që, si Deliusi, komentuesi gjerman i Shekspirit, tha se Shekspiri nuk i ka ndjerë ato që ka shkruar në sonetet, se ato vetëm i ka përfytyruar, se nuk kanë të bëjnë fare me jetën, se janë "kështjella në ajër" me të cilat ai ngushëllonte veten. Disa komentues të huaj të Shekspirit kanë thënë se sonetet e Shekspirit s'janë gjë tjetër veçse ushtrime retorike, ose madrigale të shkruara në raste të ndryshme.

Por krejt ndryshe kanë menduar poetë të vërtetë. Goete ka thënë se "në sonetet e Shekspirit çdo fjalë të



lëndon". Dhe poeti Worsdsworth i ka quajtur sonetet " çelësi me të cilin Shekspiri na ka hapur zemrën e vet."

Sonetet e Shekspirit janë poezi të vërteta lirike. Nganjëherë tek ato vihet re një kumbim epik i poezisë mesjetare. Në sonetin 106, poeti thotë se "bukurinë e asaj që dashuron e kanë parandjerë dhe parakënduar poetët e lashtë që thurnin vjersha për zonja dhe kalorës të hirshëm:

*Si ne pasqyrë kur shoh vetë bukurinë
E dorës, këmbës, buzës, syrit tënd,
Vallë si do ta thurte penda e lashtë lavdinë
Tënde sikur të t'shihte përnjimend?*

Sonetet nuk këndojnë vetëm dashurinë e mikut dhe të zonjës zeshkane. Ja ç'thotë poeti në sonetin 31:

*Në gjirin tënd gjithë zemrat kanë selinë
Të cilat kallur thosha janë në dhe;
Të dashurve të zhdukur bukurinë
Të pavenitur ruajtur e ke.
... Fytyrat më të dashura i gjej tek ti.
I yti (i gjithë atyre) jam tani.*

Sonetet e Shekspirit jo vetëm që janë plot ndjenja të bukura dhe të çiltra, por janë ngjeshur edhe me mendime të thella, me psikologji e filozofi të thellë. Nuk ka sonet që të mos kumbojë në vesh si monologët e famshëm të tragjeditive apo të komedive dhe të mos dredhë gilcat e zemrës me jone të



thekshme: A nuk të kujton vargu i parë i sonetit 23 "Si një aktor i dobët që në skenë..." vargjet, po të Shekspir: "All the world's a stage, and all the men and women merely players..." " Si të më qeshë buza pa më thuj" (28); " Kur sjell ndër mend kujtimin e nemitur" (30); " Kur shoh se dora e Kohës kaq mizore (64); " Kur bronzi, guri, toka, deti pa kufi (65); Ja edhe soneti 66 që i bën jehonë monologut të famshëm të Hamletit:

I lodhur nga të gjitha vdekjen e thërras...

Disa sonete kanë tingullin e një niseje dialogu. Ja si i drejtohet poeti atij ose asaj që dashuron:

Në gjirin tënd gjithë zemrat kanë selinë... (31)

... Ti, që me hijen tënde hijet i fekstin... (43)

... Mbaj zi për mua ditën që të vdes ... (71)

Aq shpesh ke qënë për mua muza ime...(78)

Jo, kurrë mos më quaj të pabesë (109)

Lexoni me vëmendje sonetin 128 dhe do të ndjeni si kumbojnë tingujt e muzikës së përftuar nga gishtërinjtë që gudulisin preklat çapkenë të tastierës që ngrihen e puthin pëllëmbën e atyre duarvetë bukura që luajnë me to. Një herë tjetër, kur poeti nuk monologon, as dialogon, mbyllet në vetvete dhe mediton: " Sa herë e kam shijuar bukurinë" (33); " Kur koha e nëmur do të bëjë kërدينë" (63); " Posi lëngatë është zjarri i dashurisë" (147). Lexoni gjithashtu me vëmendje



sonetet 33 dhe 65 dhe do të shihni se Shekspiri kishte në shpirt atë xixë që shkëlqente edhe në shpirtin e Buonarotit dhe Leonardos. Ja si fillon soneti 33:

*Sa herë e kam shijuar bukurinë
E nadjes dielli majat kur ndriçon;
Kur shtrin fytyr'n e artë në lëndinë
Dhe ujërat e zbeta i praron;"*

Këto vargje të shfaqin menjëherë perspektivën e tablosë që zbulohet para syve të tu: dielli që lind dhe që ndrit së pari majat e maleve dhe pastaj derdh dritën e tij poshtë në lëndinë dhe në ujrat e zbeta. Ja edhe një perspektivë tjetër që hapet që në kadencat e vargut të parë të sonetit 65: "Kur bronzi, guri, toka, deti pa kufi ..." E shohim menjëherë monumentin (bronzi), piedestalin (guri), tokën, ku pushon piedestali dhe detin që shtrihet pa kufi nga bregu i saj. Vështrimi zbret nga lart poshtë dhe shtrihet në pafundësi. Ç'mesazh ka dashur të na komunikojë Shekspiri me këtë sonet? Mendimin se monumentet prej bronzi, guri, toka, deti, shkrepate maleve, dyert prej çeliku nuk i qëndrojnë dot vdekjes që i prish të gjitha. Ky mesazh jepet në shumë sonete, që në ato të parat kur poeti, kur mendon se ç'kërdi bën Kohambinatyre dhe njerzit, këshillon mikuntë martohet dhe të lërë një djalë që të trashëgojë bukurinë e tij; pastaj



edhe në sonetet 63 dhe 65. Si mund t'i bëhet ballë kësaj prishjejetë përjetshme? Vetëm meanën enjë trashëgimtari në rastin gjenetik dhe të artit në mbretërinë e shpirtit:

*... veçse në ngjafhtë kjo mrekulli
Që në mellan'e zi të ndrish përjetë ti.*

* * *

Përtë shijuar sonetet e Shekspirit duhet të kthehemi në atë epokë kur, pas të mugëtisë të mesjetës, filluan të ndrinin rrezet e diellit që lajmëronin agimin e një jete të re. Botëkuptimi që kishin njerzit për botën, tokën, jetën, diellin, u ndryshua me krijimin e rrethanave të reja si pasojë e zbulimeve të njëpasnjëshme që bëheshin në fusha të ndryshme. "Doubt that the sun doth move" i shkruan Hamleti Ofelisë (Dysho se dielli lëviz = thuaj dielli lëviz) sepse, sipas mendësisë së atyre të mesjetës, toka dhe dielli ishin të palëvizshëm. Mori hovtregtia, marrëdhëniet e vjetra feudale, që besoheshin të palëkundshme dhe të përjetshme, u shturën; qytete zunë e u rritën; anijet e tregtarëve, "të kërkuesve të aventurave", siç i quanin atëherë, filluan të çajnë ujërat e oqeanëve dhe të lëvizin në hapësira të



pamatshme dhe të pamenduara deri atëhere. Dhe ashtu si shtyheshin kufijtë e horizontit gjeografik dhe astronomik, shtriheshin dhe ata mendorë dhe shpirtërorë. Ishte epoka e vendosjes së vetëdijes. " Dije pa vetëdije është rrënimi i shirtit" thoshte i madhi Rabelais që pati 500 vjetorin e lindjes më 1994 dhe që s'u zu fare në gojë në vendin tonë. Filozofi anglez Francis Bacon flaku tej të ashtuquajturat " të vërteta të përjetshme" të skolastikëve mesjetarë, hodhi idenë e krijimit të shkencës të bazuar në eksperimentimin, në mësimin e sendeve. Vendin qëndror në botëkuptimin e Rilindjes e zuri **njeriu**. Në letërsi dhe poezi vërshuan dhe gëluan ndjenjat e gjalla të njeriut. Sonetet e Shekspirit janë pasqyrë e gjallë e këtyre ndjenjave.

Ndonëse shkrimtarët e mesjetës thoshin se jeta tokësore është e brishtë dhe kalimtare, bota, në ndërgjegjen e tyre, ishte si një tablo e palëvizshme. Prozatorët dhe poetët e epokës së Rilindjes flisnin dhe shkruanin për ndryshueshmërinë e përjetshmetë qënies. Siç e pamë, lufta kundër fuqisë rrënimtare të plotfuqishme të Kohës është një nga temat e parapëlqyera të soneteve të Shekspirit. Në këtë luftë njeriu, siç thamë, ka vetëm dy armë: trashëgiminë dhe artin.

Dhe kur n'acar të pleqërisë të ngrish



Gjakun të nxeht' në dej do ndjesh sërish.

(Në qoftë selë trashëgimtar (soneti 2). Kyle it motiv përsëritet edhe në sonetet e tjerë. Nga ana tjetër, vetëm fuqia e artit do t'i bëjë ballë prishjes së përjetshme të Kohës:

*Se nuri i tij, në këtë varg të zi
I gjallë do të mbetet si ai (Soneti 63)*

Trashëgimia e njeriut është arti i tij, po ashtu edhe arti i tij mund të quhet trashëgimia e tij. Vdekja dhe prishja më në fund munden dhe jeta triumfon mbi to.

Sonetet e Shekspirit janë mbrujtur me pathosin e bukurisë së jetës, me thirrjen e zjarrtë të poetit për vazhdimësinë e jetës. Ato, si edhe e gjithë veprimtaria e tij, na grishin për të shkuar përpara drejt së ardhmes.

Sonetet e Shekspirit janë të çmuara për ne sepse ato u bëjnë jehonë tragjedia dhe komedia të tij. Lexoni sonetin 64 dhe do të shihni si revoltohet shpirti i poetit kur sheh përçmimet që bëjnë ligjin rreth tij:

*...Kur shoh meritën mbetur si jetim...
Dhe besimin e shkelur me përçmim...
Dhe nderin lemerisht të poshtëruar...
Dhe forcën nga i çali të munduar...*

Këto janë përplasjet e pashmangshme që u bëjnë jehonë atyre të Hamletit, Makbethit etj.



Për fat të keq, kjo përmbledhje e vogël e soneteve të Shekspirit jep vetëm dritën e vagëlluar të agimit, ose të asaj të të mugëtit të mbrëmjes. Sonetet do të shkëlqenin në tërë dritën e tyre verbuese të diellit të mesditës sikur edhe ato që kanë mbetur fshehur t'i kapte kjo dritë. Në pritje, uroj që dikush tjetër të marrë këtë mundim dhe ta shtojë këtë thesar.

Vedat Kokona








Formati 70x100/32.

Tirazhi 2000

Shtypur në Shtypshkronjën " **EDLOR** " Tirane





WILLIAM SHAKESPIR

Sonete

Në anglisht dhe shqip



Shqipëroi
Vedat Kokona



Çmimi për blerësin: 100 lekë